

V E N D I M
Nr. 506, datë 21.9.2000

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË
CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I KRYQËZIMIT NË ZONËN E PLEPAVE, DURRËS,
PJESË E SEGMENTIT RRUGOR DURRËS-ROGOZHINË**

(Ndryshuar me VKM nr. 166¹, datë 13.3.2003)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të neneve 5, pika 1, dhe 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private për interes publik", me propozimin e ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, që preken nga ndërtimi i kryqëzimit rrugor në zonën e plepave, Durrës, pjesë e segmentit rrugor Durrës-Rrogozhinë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Ministrisë së Transportit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të shpërblehen në vlerë të plotë, sipas masës së shpërblimit që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, në shumën e përgjithshme prej 12 106 748 (dymbëdhjetë milionë e njëqindëgjashtë mijë e shtatëqindëdyzetetë) lekësh.

3/1. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, me sipërfaqe 7005 m² tokë/truall, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 56 187 105 (pesëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e pesë) lekësh.

4. Fondi për shpërblimin e pronarëve të shpronësuar, sipas pikës 3 të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i vitit 2000 i Ministrisë së Transportit, në zërin "Shpronësime".

4/1. Fondi prej 56 187 105 (pesëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e pesë) lekësh, si dhe shpenzimet procedurale prej 319 200 (treqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyqind) lekësh, të përballohen nga buxheti i vitit 2003, zëri "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit.

5. Shpronësimi të përfundojë brenda muajit tetor 2000.

5/1. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.4.2003.

6. Punimet për realizimin e projektit të fillojnë pas mbarimit të procedurave të shpronësimit dhe të mbarojnë brenda muajit nëntor 2000.

7. Ngarkohet Ministria e Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

¹ VKM nr. 166, datë 13.3.2003 në pikën 2 shprehet:

"2. Mënyra e pagesës të bëhet pas paraqitjes së dokumenteve të pronësisë, sipas ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999."

**Lista e pronarëve që shpronësohen për efekt të ndërtimit të segmentit rrugor
Durrës-Rrogozhinë**

Lloji i pasurisë së paluajtshme: Truall Nr. (1-3)

Nr.	EmërAtësi Mbiemër	V.K.K.K.P (datë)	Leje ndërtimi (datë)	Sip.trualli m2	Çmimi (lekë/ m2)	Vlera në (lekë)	Shënime
1.	Demir Xhafa	7.3.1994	23.9.1996	805 m2	26515	2134457	
	Demir Xhafa						Pretendim
2.	Rexhep Hersi	25.12.1995	23.9.1996	3230	26515	8564345	Pronësie
3.	Hamza Muça	4.7.1996	23.9.1996	531	26515	1407946	Në gjykim
	Shuma:			4566		12106748	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QARKU DURRËS

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË
SEGMENTIT RRUGOR DURRËS-RROGOZHINË (VIADUKATI PLEPA)**

(Shtuar me VKM nr. 166, datë 13.3.2003)

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Truall		Vlera lekë	Shënime
				Sip.m2	Çmimi Lekë/m2		
1	Robert	Kozma	Kote	2700	8021	21656700	Konflikt gjyqësor
2	Xhevahire	Osman	Marku	1615	8021	12953915	
3	Rudin	Sofokli	Mukja	502	8021	4026542	
4	Haxhi	Xhelal	Nezha	495	8021	3970395	
5	Jakup		Ismaili	98.6	8021	790870.6	
	Arben		Ismaili	98.6	8021	790870.6	
	Shehri		Ismaili	98.6	8021	790870.6	
	Sefer		Ismaili	98.6	8021	790870.6	
	Bashkim		Ismaili	98.6	8021	790870.6	

6	Trashëgimtarët e Jakup Troplinit			1200	8021	9625200	
		Totali		7005	8021	56187105	

Shuma totale e shpronësimit 56187105 lekë Shpenzime procedurale 319200 lekë.